

Qershor 2025 | Nr. 50

BULETINI MUJOR

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

www.ild.al | info@ild.al



Inspektori i Lartë i Drejtësisë



@ILD_Albania



Inspektori i Lartë i Drejtësisë

**METANI: PAVARËSIA DHE LLOGARIDHËNIA E
MAGJISTRATËVE, NJË DUALITET ORGANIK QË E
BËN DHËNIEN E DREJTËSISË SI SHËRBIM PUBLIK**





METANI: PAVARËSIA DHE LLOGARIDHËNIA E MAGJISTRATËVE, NJË DUALITET ORGANIK QË E BËN DHËNIEN E DREJTËSISË SI SHËRBIM PUBLIK

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në konferencën kombëtare “Dimensioni i integritetit në funksionin e magjistratit. Angazhimi ndaj drejtësisë”, organizuar nga Shkolla e Magjistraturës, me kontribuues drejtues të institucioneve të drejtësisë, magjistratë, juristë, pedagogë e përfaqësues të shoqërisë civile.

Zoti Metani referoi mbi temën “Shteti i së Drejtës në Provë: Pavarësi apo Llogaridhënie?” duke analizuar marrëdhënien dinamike e delikate, që ekziston ndërmjet pavarësisë të pushtetit gjyqësor dhe nevojës legjitime për llogaridhënie publike, objekt debati sot mes profesionistëve të së drejtës, edhe në Evropë e më

gjerë. Pavarësia formale ligjore e magjistratëve kërkon garanci institucionale, por duhet të shoqërohet me një standard të lartë integriteti dhe profesionalizimi të vetë magjistratëve, tha Inspektori i Lartë i Drejtësisë në fjalën e vet.

“Në praktikën shqiptare ky parim është vënë shpesh në provë. Magjistratët janë ekspozuar jo rrallë herë ndaj ndërhyrjeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të cilat janë manifestuar nëpërmjet intimidimeve personale, presioneve mediatike, diskurseve të polarizuara politike, përdorimit të retorikës politike për të ndikuar perceptimin dhe vendimarrjen gjyqësore, konfliktit të interesit, apo vendimarrjeve të centralizuara administrative, të

mbështetura jo gjithmonë në kritere apo pavarësisë së magjistratëve duhet të procedura të qarta ligjore. Adresimi i kësaj shoqërohet me një sistem llogaridhënës problematike kërkon ndërtimin e një kul- efektiv.

ture institucionale të mbrojtjes së

pavarësisë së magjistratëve, ngritjen e Inspektori i Lartë i Drejtësisë tha zoti Me- mekanizmave mbikëqyrës dhe lloga- tani përfaqëson mekanizmin themelor, që ridhënës të pavarur, si dhe vendosjen e lidh pavarësinë e magjistratit me sistemin standardeve të qarta mbi deontologjinë llogaridhënës dhe përgjegjësinë publike të politike, në raport me marrëdhëniet e saj tyre.

me pushtetin gjyqësor....Rrjedhoja më e

rëndësishme e parimit të pavarësisë së “Sfida më e madhe sot e Inspektorit të magjistratëve është mos përgjegjësia për Lartë të Drejtësisë është të ruajë vendimet që japin, sipas bindjes së tyre pavarësinë e tij institucionale, si dhe të jetë mbështetur në ligj. Në gjykimin e një një kontribuues i rëndësishëm në garanti- çështjeje, ata marrin vendime mbështetur min e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, në në ligj dhe sipas bindjes së tyre të një mjedis ku ndikimi apo ndërhyrjet e brendshme. Por pavarësia funksionale dhe drejtpërdrejta ose të tërthorta ndaj personale nuk nënkupton imunitetin apo pushtetit gjyqësor nuk janë të panjohura. mungesën e kontrollit.

Prandaj, pasoja e pushtetit dhe besimi që gjyqësor, ILD po përpiket të zbatojë stand- shoqëria i jep magjistratëve është e tillë, që ardet më të larta të procesit të rregullt duhet të ketë disa mënyra për t’i mbajtur ligjor, të sigurojë transparencë në proce- përgjegjës. Çdo përpjekje për të mbrojtur durat e zhvilluara nga ana e tij, si dhe të pavarësinë e pushtetit gjyqësor nuk është dëshmojë integritet në çdo vendimmarrje. legjitime, nëse nuk shoqërohet me reagim Këtë mekanizëm llogaridhënës, ILD po mbi formën, thelbin dhe kufijtë e ushtrimit përpiket të konceptojë dhe të aplikojë në të sistemit llogaridhënës të magjistratëve, mënyrë institucionale, të drejtë dhe të pasi pa rregulla të qarta për kontrollin e qëndrueshme, si forma më e lartë e pushtetit gjyqësor, rrezikojmë t’i shndërro- përgjegjshmërisë publike të magjistratëve. jmë magjistratët në një sovran të Roli i ILD-së nuk duhet parë thjesht në di- heshtur. Pra rritja e kompetencës dhe mensionin ndëshkues disiplinor, por në një

Pavarësia formale ligjore e magjistratëve kërkon garanci institucionale, por duhet të shoqërohet me një standard të lartë integriteti dhe profesionalizimi të vetë magjistratëve, tha Inspektori i Lartë i Drejtësisë në fjalën e vet.

prizëm më të gjerë edukues dhe parandalues, në funksion të krijimit të një kulture të lartë etike dhe profesionale në pushtetin gjyqësor. Në këtë mënyrë, ky institucion po angazhohet të shndërrohet në një mbështetës të vërtetë të parimeve të shtetit të së drejtës, duke ruajtur ekuilibrin e ndjeshëm mes llogaridhënies dhe pavarësisë të pushtetit gjyqësor”.

Duke e parë pavarësinë dhe llogaridhënien si një dualitet organik, që ndihmon në konsolidimin e shtetit të së drejtës, zoti Metani vërejti se duhet reflektuar për ndërtimin e një drejtësie që t’i garantojë të dyja, ndërsa dhënia e drejtësisë duhet të jetë një shërbim publik. “Sot më shumë se kurrë, drejtësia në Shqipëri ka nevojë për magjistratë dhe profesionistë me integritet të lartë moral, të ndërgjegjshëm për rolin e tyre kushtetues dhe të përkushtuar ndaj drejtësisë, si një shërbim publik, duke ruajtur të pastra interesat e saj. Ka nevojë për magjistratë që besojnë realisht, jo vetëm në vlerat shoqërore, por edhe në misionin e tyre personal për të shërbyer në sistemin e drejtësisë. E lidhur natyrshëm kjo edhe me forcimin e mëtejshëm të përgjegjshmërisë dhe të përgjegjësisë. Të gjithë ne, si pjesëtarë të sistemit të drejtësisë, kemi detyrën që përmes praktikës sonë, sjelljes institucionale dhe kulturës profesionale, të dëshmojmë se pavarësia nuk është privilegj personal i magjistratëve, por një mjet në shërbim të qytetarit dhe se llogaridhënia nuk është kufizim apo cenim i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, por një mekanizëm për ta ushtruar këtë pavarësi me përgjegjësi. Në të njëjtën kohë, çmoj se është po kaq i rëndësishëm respektimi i funksionimit të mekanizmit kushtetues të kësaj balance të rëndësishme, si një mjet, ndoshta i vetmi, për rizgjimin e sistemit të drejtësisë, si një shërbim publik, duke i gjyqësor”.



Fjala e plotë e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë z. Artur Metani

Përshëndetje të gjithëve!

Fillimisht më lejoni të përgëzoj organizatorët e kësaj konference, zotin Rakipi dhe Shkollën e Magjistraturës, për sjelljen në debat të një prej çështjeve më themelore të debatit kushtetues dhe të rendit demokratik sot, jo vetëm në Shqipëri, por edhe në Evropë e më gjerë, siç është *marrëdhënia dinamike e delikate që ekziston ndërmjet pavarësisë të pushtetit gjyqësor dhe nevojës legjitime për llogaridhënie publike*. Një çështje që është kthyer në provën reale të shtetit të së drejtës, si pjesë e sprovave që po kalon ngado drejtësia. Prandaj do doja të shfrytëzoj këtë mundësi për të ndarë me ju disa reflektime të miat, mbi çështjet shumë të rëndësishme dhe themelore që aktualisht sot lidhen me angazhimin e magjistratëve dhe rolin e tyre të qenësishëm në sistemin e drejtësisë.

Pavarësia e pushtetit gjyqësor përbën në vetvete një gur themeli të një shteti demokratik dhe është e pandashme nga vetë kuptimi i funksionimit të shtetit të së drejtës. Por po kaq i rëndësishëm sa ky parim, duhet evidentuar se në shoqëritë tona sot po vërehet, për sa e përshkruan edhe ish-Inspektori i Lartë francez, një *paradoks i çuditshëm: "Asnjëherë kërkesa për drejtësi nuk ka qenë kaq e fortë dhe asnjëherë sistemet e drejtësisë nuk kanë qenë në gjendje kaq të brishtë"*. Ndoshta dhe për këtë arsye, apo në emër të saj, disa shoqëri po përballen me një *"ndikim"* agresiv të pushtetit ekzekutiv (apo atij legjislativ) ndaj pushtetit

gjyqësor dhe ndërkohë kërkimi dhe aplikimi i mekanizmave të nevojshme për të mbrojtur pavarësinë e sistemit gjyqësor mbetet ende sfidë, edhe në vendet me demokraci të zhvilluar.

Ky realitet e bën edhe më të domosdoshëm konsolidimin e një arkitekture institucionale, që i garanton magjistratëve jo vetëm pavarësinë formale ligjore, por edhe mbështetjen morale dhe shoqërore për të ushtruar funksionin e tyre në mënyrë të pavarur, të paanshme, të guximshme dhe të drejtë. Ky është një proces i natyrshëm transformimi dhe zhvillimi i vazhdueshëm. Patjetër, çdo model institucional është i ndryshëm dhe duhet kuptuar nën dritën e stadit të zhvillimit të një vendi të caktuar.

Pavarësia e pushtetit gjyqësor përmban dy dimensione, aspektin institucional dhe atë etiko-personal. Kështu, pavarësia e pushtetit gjyqësor kërkon garanci të qarta në aspektin institucional, por nga ana tjetër kjo pavarësi duhet të shoqërohet me një standard të lartë integriteti dhe profesionalizimi të vetë magjistratëve.

Në praktikën shqiptare ky parim është vënë shpesh në provë. Magjistratët janë ekspozuar jo rrallë herë ndaj ndërhyrjeve të drejtpërdrejta apo të tërthorta, të cilat janë manifestuar nëpërmjet intimidimeve personale, presioneve mediatike, diskurseve të polarizuara politike, përdorimit të retorikës politike për të ndikuar perceptimin dhe vendimmarrjen gjyqësore, konfliktit të interesit, apo vendimmarrjeve të centralizuara administrative, të mbështetura jo gjithmonë në kritere apo procedura të qarta ligjore. Adresimi i kësaj problematike kër-



kon ndërtimin e një kulture institucionale të mbrojtjes së pavarësisë së magistratëve, ngritjen e mekanizmave mbikëqyrës dhe llogaridhënës të pavarur, si dhe vendosjen e standardeve të qarta mbi deontologjinë politike, në raport me marrëdhëniet e saj me pushtetin gjyqësor.

Në të njëjtën kohë, mungesa e pavarësisë ka ardhur dhe si pasojë e sjelljeve të njëanshme nga ana e vetë magistratëve, si pasojë e mungesës së formimit profesional, sjelljeve të kryera me keqdashje të drejtpërdrejtë, apo si pasojë e mungesës së etikës dhe integritetit të tyre.

Për këtë qëllim, është e nevojshme që sistemi ynë i së drejtës, të ketë një përgjigje aktive dhe dinamike ndaj sfidave që lindin, si dhe një përshtatje sistematike ndaj nevojave të vazhdueshme për të garantuar këtë pavarësi e përgjegjshmëri. Ky proces duhet të fillojë me një vëmendje të shtuar,

që në fazat e hershme të shkollimit të magistratëve pranë Shkollës së Magjistraturës dhe në vazhdim përgjatë ecurisë profesionale të tyre.

Rrjedhoja më e rëndësishme e parimit të pavarësisë së magistratëve është mos përgjegjësia për vendimet që japin, sipas bindjes së tyre mbështetur në ligj. Në gjykimin e një çështjeje, ata marrin vendime mbështetur në ligj dhe sipas bindjes së tyre të brendshme. Por pavarësia funksionale dhe personale nuk nënkupton imunitetin apo mungesën e kontrollit.

Prandaj, pasoja e pushtetit dhe besimi që shoqëria i jep magistratëve është i tillë, që duhet të ketë disa mënyra për t'i mbajtur përgjegjës. Çdo përpjekje për të mbrojtur pavarësinë e pushtetit gjyqësor nuk është legjitime, nëse nuk shoqërohet me reagim mbi formën, thelbin dhe kufijtë e ushtrimit

të sistemit llogaridhënës të magjistratëve, pasi pa rregulla të qarta për kontrollin e pushtetit gjyqësor, rrezikojmë t'i shndërrojmë magjistratët në një sovran të heshtur. Pra rritja e kompetencës dhe pavarësisë së magjistratëve duhet të shoqërohet me një sistem llogaridhënës efektiv.

Llogaridhënia e pushtetit gjyqësor nuk duhet të shihet si një kufizim ndaj pavarësisë së tij, por si një parakusht për garantimin e legjitimitetit institucional dhe përf forcimin e besimit publik tek drejtësia. Ajo nuk duhet konceptuar si kufizim i pavarësisë, por si një mekanizëm që e forcon atë. Respekti për drejtësinë nuk qëndron vetëm në vendimet e saj, por edhe në mënyrën se si merren vendimet gjyqësore. Pra, forma se si vendoset drejtësia është po aq e rëndësishme sa dhe përmbajtja e saj.

Në këtë kuptim, llogaridhënia përfaqëson jo vetëm nivelin më të lartë të përkushtimit ndaj qytetarëve dhe respektimit të misionit themelor të drejtësisë, por përfaqëson edhe aftësinë e pushtetit gjyqësor për të reflektuar mbi veprimtarinë e tij, për të justifikuar sjelljen institucionale, për të përmirësuar cilësinë e drejtësisë dhe për të vepruar në përputhje me standardet më të

larta të etikës dhe profesionalizmit.

Në Shqipëri, reforma në drejtësi solli një transformim rrënjësor institucional duke synuar rivendosjen e besimit të publikut në drejtësi përmes ndërtimit të institucioneve të reja dhe forcimit të standardeve profesionale. Ndër këto institucione, një rol kyç luan Inspektori i Lartë i Drejtësisë (ILD), i cili përfaqëson mekanizmin themelor, që lidh pavarësinë e magjistratit me sistemin llogaridhënës dhe përgjegjësinë publike të tyre.

Sfida më e madhe sot e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është të ruajë pavarësinë e tij institucionale, si dhe të jetë një kontribuues i rëndësishëm në garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, në një mjedis ku ndikimi apo ndërhyrjet e drejtpërdrejta ose të tërthorta ndaj pushtetit gjyqësor nuk janë të panjohura. Për të mos u shndërruar në një mjet presioni ndaj magjistratëve dhe pushtetit gjyqësor, ILD po përpiqet të zbatojë standardet më të larta të procesit të rregullt ligjor, të sigurojë transparencë në procedurat e zhvilluara nga ana e tij, si dhe të dëshmojë integritet në çdo vendimarrje.

Këtë mekanizëm llogaridhënës, ILD po përpiqet të konceptojë dhe të aplikojë në mënyrë institucionale, të drejtë dhe të

Sfida më e madhe sot e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është të ruajë pavarësinë e tij institucionale, si dhe të jetë një kontribuues i rëndësishëm në garantimin e pavarësisë së pushtetit gjyqësor, në një mjedis ku ndikimi apo ndërhyrjet e drejtpërdrejta ose të tërthorta ndaj pushtetit gjyqësor nuk janë të panjohura.

qëndrueshme, si forma më e lartë e përgjegjshmërisë publike të magistratëve. Roli i ILD-së nuk duhet parë thjesht në dimensionin ndëshkues disiplinor, por në një prizëm më të gjerë edukues dhe parandalues, në funksion të krijimit të një kulture të lartë etike dhe profesionale në pushtetin gjyqësor. Në këtë mënyrë, ky institucion po angazhohet të shndërrohet në një mbështetës të vërtetë të parimeve të shtetit të së drejtës, duke ruajtur ekuilibrin e ndjeshëm mes llogaridhënies dhe pavarësisë të pushtetit gjyqësor.

Kjo nuk është vetëm një *retorikë*, por një parim i rëndësishëm në të cilin ILD beson vërtetë. Gjithashtu, kjo është dhe një sfidë e vështirë, e cila mund të përballohet vetëm nëpërmjet një qasje të matur dhe të kujdesshme, duke mos iu nënshtruar debatteve të nxehta të momentit, por duke mbajtur në konsideratë efektet afatgjata

dhe një qëllim të vetëm, ngritjen dhe funksionimin në të ardhmen e një pushteti gjyqësor mbi themele të forta të pavarësisë dhe përgjegjësisë. Kjo jo vetëm që kërkon kohë, por edhe qëndrueshmëri. Realisht besoj se jemi në rrugën e duhur.

Në vijim të këtij reflektimi mbi ekuilibrin ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies së magistratëve, ndihem i detyruar të theksoj se këto dy parime nuk janë në konflikt me njëri-tjetrin, por në një *simbiozë të shëndetshme*, që garanton funksionimin e shtetit të së drejtës. Dilema klasike mes pavarësisë dhe llogaridhënies është në thelb një sfidë për të ndërtuar një simetri funksionale ndërmjet tyre, një ekuilibër që nuk është vetëm një kërkesë ligjore, por një parakusht i rëndësishëm për ruajtjen e legjitimitetit të pushtetit gjyqësor.

Gjetja e një ekuilibri të qëndrueshëm



ndërmjet këtyre dy vlerave përbën një sfidë të vazhdueshme. Pavarësia absolute, në mungesë të mekanizmave të llogaridhënies efektive, rrezikon të sjellë mungesë të efikasitetit, mungesë transparence dhe cenim të parimeve të përgjegjshmërisë institucionale dhe publike të magistratëve. Në të njëjtën kohë, ngritja e një mekanizmi llogaridhënës ndaj magistratëve, jo i mbështetur në kriterë apo standarde ligjore dhe jo në kuadër të zhvillimit të procedurave sipas një procesi të rregullt ligjor, mund të përbëjë një rrezik serioz për pavarësinë e pushtetit gjyqësor dhe ta ekspozojë atë ndaj ndikimeve të papërshtatshme, përfshirë ndërhyrjet e natyrës politike.

Në pamje të parë, kjo marrëdhënie mund të paraqitet si një konflikt i pashmangshëm ndërmjet të drejtës për pavarësi të pushtetit gjyqësor dhe kontrollit institucional ndaj ushtrimit të funksioneve gjyqësore. Por në një rend kushtetues të konsoliduar, pavarësia e gjyqësorit dhe llogaridhënia ndërtohen si dy dimensione plotësuese të së njëjtës arkitekturë institucionale, duke përfaqësuar një *dualitet organik* dhe të pazëvendësueshëm, i cili ndihmon në konsolidimin e shtetit të së drejtës.

Pra, në këtë kuadër, pyetja që shtrohet nuk është *“Pavarësi apo llogaridhënie?”*, por *“Si të ndërtojmë një drejtësi që garanton të dyja?”*, pasi marrëdhënia mes tyre është jo vetëm teorike, por edhe praktike dhe ekzistenciale për vetë funksionimin e shtetit të së drejtës.

Një rend kushtetues që synon të garantojë barazi para ligjit, mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut dhe funksionim të rregullt të institucioneve demokratike, nuk mund të përfytyrohet pa një pushtet gjyqësor të pavarur dhe njëkohësisht të përgjegjshëm ndaj shoqërisë. Vetëm përmes *ekuilibrit të drejtë* ndërmjet këtyre dy parimeve themelore mund të ndërtohet një drejtësi, që është njëkohësisht e pavarur në vendimmarrje dhe funksionon në mënyrë efikase dhe me integritet.

Të nderuar kolegë!

Shqipëria ndodhet sot në një moment të rëndësishëm, ku sfida për të konsoliduar institucionet e reja të drejtësisë nuk mund të fitohet pa një ndërgjegjësim të thellë institucional dhe shoqëror mbi rolin e drejtësisë në një shtet të së drejtës.

Shteti i së drejtës nuk përfaqëson vetëm

Një rend kushtetues që synon të garantojë barazi para ligjit, mbrojtje të të drejtave themelore të njeriut dhe funksionim të rregullt të institucioneve demokratike, nuk mund të përfytyrohet pa një pushtet gjyqësor të pavarur dhe njëkohësisht të përgjegjshëm ndaj shoqërisë.

një aspekt rregullash dhe normash juridike, por edhe një rend shoqëror ku mbizotëron ligji, ku ndarja funksionale e pushteteve është jo vetëm një *parim teoritik*, por një mekanizëm real dhe i “gjallë” kontrolli, ku të drejtat themelore të njeriut gëzojnë një status të patjetërsueshëm dhe të mbrojtur përmes mjeteve efektive juridike.

Sfida për ndërtimin e një shteti të së drejtës nuk është vetëm ligjore në kuadër të një procesi legjislativ, por edhe historike, institucionale, kulturore apo shoqërore. Ajo kërkon një përpjekje të përbashkët të të gjitha pushteteve për të kultivuar një sistem ku të gjithë janë të barabartë përpara ligjit dhe ku qytetari ka besim real në funksionin mbrojtës të drejtësisë. Ndërkohë, vlen të theksohet se gjykatat, në këtë *paradigmë*, nuk janë vetëm interpretuese të ligjit, por garantuese të rendit kushtetues dhe mbrojtëse të parimit të shtetit të së drejtës.

Reforma në drejtësi, e miratuar në vitin 2016, përfaqëson një ndërmarrje madhore strukturore në jetën juridike dhe institucionale të vendit tonë, duke synuar rivendosjen e besimit të publikut në pushtetin gjyqësor. Ajo u konceptua si një ndërhyrje gjithëpërfshirëse për të adresuar *problemet sistematike* të korrupsionit, mungesës së efikasitetit dhe ndikimit politik në lidhje me funksionimin e sistemit të drejtësisë për një periudhë të gjatë tranzicioni.

Por reforma në drejtësi nuk mund të mbetet një iniciativë e ngurtësuar në akte ligjore, apo struktura institucionale for-

male. Ajo duhet të gjejë mishërim në funksionimin e organeve të pushtetit gjyqësor, si dhe në sjelljen etike të magjistratëve, në pavarësinë e vendimarrjes së tyre dhe në refuzimin e ndëshkimit e çdo përpjekjeje për instrumentalizimin e saj.

Reforma në drejtësi ka qenë një hap madhor, por jo i mjaftueshëm. Që efektet e saj të jenë të prekshme, duhet të shoqërohet me një reflektim të thellë profesional e përkushtim për ndërtimin e institucioneve që gëzojnë besimin e qytetarëve shqiptarë. Për këtë nuk nevojiten vetëm reforma ligjore, por një transformim i kulturës institucionale, një vetëdijje e re mbi drejtësinë dhe një angazhim i përhershëm për ndershmëri dhe profesionalizëm. Pra, reforma nuk mund të jetë vetëm tërësia e ndryshimeve ligjore apo ngritja e institucioneve të reja. Ajo duhet të shoqërohet me një *transformim kulturor*, që kërkon kohezion institucional, qëndrueshmëri politike dhe maturi të shoqërisë tonë.

Le të jemi të vetëdijshëm se dështimi për të mbrojtur këtë ekuilibër të rëndësishëm ndërmjet pavarësisë dhe llogaridhënies së magjistratëve nuk përbën vetëm një shmangie nga zbatimi i frymës së parimeve dhe standardeve të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, por një krizë besimi, që cenon thelbin e legjitimitetit kushtetues të organizmit dhe funksionimit të shoqërisë tonë.

Për këtë arsye, thirrja ime sot, është për një angazhim të përbashkët të të gjithëve ne, si profesionistë të së drejtës, si

magjistratë, drejtues të institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë, akademikë, organizata të shoqërisë civile, për të kultivuar një kulturë profesionale të bazuar mbi dinjitet, vetëpërmbytje dhe kurajë qytetare, që të kontribuojmë sa më shumë në ruajtjen e këtij ekuilibri në funksion të demokracisë dhe shtetit të së drejtës, me qëllim shërbimin e saj për qytetarët dhe brezat e ardhshëm.

Sot më shumë se kurrë, drejtësia në Shqipëri ka nevojë për magjistratë dhe profesionistë me integritet të lartë moral, të ndërgjegjshëm për rolin e tyre kushtetues dhe të përkushtuar ndaj drejtësisë, si një shërbim publik, duke i ruajtur të pastra interesat e saj. Ka nevojë për magjistratë që besojnë realisht, jo vetëm në vlerat shoqërore, por edhe në misionin e tyre personal për të shërbyer në sistemin e drejtësisë. E lidhur natyrshëm

kjo edhe me forcimin e mëtejshëm të përgjegjshmërisë dhe të përgjegjësisë. Të gjithë ne, si pjesëtarë të sistemit të drejtësisë, kemi detyrën që përmes praktikës sonë, sjelljes institucionale dhe kulturës profesionale, të dëshmojmë se pavarësia nuk është privilegj personal i magjistratëve, por një mjet në shërbim të qytetarit dhe se llogaridhënia nuk është kufizim apo cenim i pavarësisë së pushtetit gjyqësor, por një mekanizëm për ta ushtruar këtë pavarësi me përgjegjësi.

Në të njëjtën kohë, çmoj se është po kaq i rëndësishëm respektimi i funksionimit të mekanizmit kushtetues të kësaj balance të rëndësishme, si një mjet, ndoshta i vetmi, për rizgjim të sistemit gjyqësor.

Ju faleminderit!





METANI: DUHET QASJE E RE, PASI DHËNIA E DREJTËSISË ËSHTË NJË SHËRBIM PUBLIK ME IMPAKT TË THELLË NË SHOQËRI

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në mbledhjen e parë të përbashkët të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë me fokus tek inspektimet tematike. Kjo iniciativë e Këshillit të Lartë të Prokurorisë u mbështet nga projekti EU4Justice.

Në fjalën e tij përshëndetëse, zoti Metani tha se sistemi i drejtësisë në Shqipëri, jo vetëm po përballët me sfidën e ringritjes dhe riorganizimit të tij, pas një reformimi të thellë, por duhet edhe të ruajë një ekuilibër të drejtë, ndërmjet problematikave dhe vështirësive që përjeton,

si dhe besimit apo kërkesave të publikut për një drejtësi cilësore, efikase, të shpejtë dhe me integritet. E për këtë, vërejt zoti Metani, duhet një qasje e re, përmes orientimit tek cilësia dhe performanca e sistemit gjyqësor.

“Sot mendoj se ka ardhur koha që të gjithë ne duhet t’i drejtojmë qëllimet, si dhe veprimtarinë e institucioneve tona, nga modeli i organeve të inspektimit të fokusuar në vlerësimin individual të gjyqtarëve dhe prokurorëve drejt vlerësimit të cilësisë dhe performancës së sistemit gjyqësor në tërësi, përmes një

modeli të bazuar në inspektimin e gjykatave dhe prokurorive”.

Duke u ndalur tek inspektimet tematike të kryera nga ILD, zoti Metani nënvizoi se synimi i tyre ka qenë konstatimi i problematikave në sistem e drejtësisë dhe rekomandimin e zgjidhjeve, rekomandime, që i kanë shërbyer përmirësimit të funksionalitetit të gjykatave dhe zyrave të prokurorive në shërbim të dhënies së drejtësisë ndaj publikut.

Nga ana tjetër, Inspektori i Lartë i Drejtësisë e vuri theksin tek bashkëveprimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve të drejtësisë, si një element i nevojshëm, jo vetëm në paraqitjen e propozimeve për kryerjen e inspektimeve tematike, por në vijimësi në fushat me impakt në veprimtarinë e magistratëve.

Fjalë përshëndetëse në nisje të mbledhjes mbajtën kryetarja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë znj. Mirela Bogdani, kryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Ilir Rusi dhe Prokurori i Përgjithshëm Olsian Çela.

Mbi perspektivën e Këshillave, roli, përfshirja dhe bashkëpunimi mbi inspektimet tematike referuan kryetari i Komisionit të Përhershëm Disiplinor të KLP, z. Zeqir Hoda dhe në emër të Komisionit të Përhershëm Disiplinor të KLGJ znj. Emona Muçi.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Metani bëri një paraqitje mbi “Situatën aktuale të Inspektimeve Tematike – përmbledhje historike, gjendja e bashkëpunimit ndërinstitucional, gjetjet kryesore dhe rekomandime”. Takimi u mbyll me diskutime e propozime mbi përmirësimin e koordinimit dhe bashkëpunimit institucional për inspektimet tematike.



Fjala e plotë përshëndetëse e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë:

E nderuar Znj. Bogdani,

I nderuar Z. Rusi,

I nderuar Z. Çela,

Të nderuar anëtarë të Këshillave,

Të nderuar pjesëmarrës.

Faleminderit për ftesën dhe mundësinë për të marrë pjesë në këtë aktivitet!

Personalisht e vlerësoj shumë organizimin e tij, pasi zhvillimi i këtij takimi është një tregues i qartë mbi vëmendjen e duhur që institucionet tona po i kushtojmë procesit të zhvillimit të inspektimeve tematike, apo institucionale ndaj organeve të pushtetit gjyqësor.

Duke dëgjuar fjalën e kolegëve të mi, në

këtë moment më erdhi në mendje shprehja e një kolegut tim ekspert në Këshillin e Evropës (*Delbos*), i cili ka asistuar në disa procese pune Zyrën e ILD mbi zhvillimin e inspektimeve tematike apo institucionale se: *“Ne sot jetojmë në një paradoks të çuditshëm: asnjëherë kërkesa për drejtësi nuk ka qenë kaq e fortë dhe asnjëherë sistemet e drejtësisë nuk kanë qenë në gjendje kaq të brishtë”*.

Kjo dilemë e shumë shteteve të tjera gjen tashmë vend edhe në Shqipëri. Kjo për faktin se, sot sistemi i drejtësisë në Shqipëri, jo vetëm po përballet me sfidën e ringritjes dhe riorganizimit të tij, pas një reformimi të thellë, por gjithashtu duhet të ruajë një ekuilibër të drejtë ndërmjet problematikave dhe vështirësive që përjeton, si dhe besimit apo kërkesave të publikut për një drejtësi cilësore, efikase, të shpejtë dhe me integritet.

Duke mos dashur aspak të nënvlerësoj sistemin llogaridhënës të



Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë i ka vlerësuar inspektimet tematike dhe institucionale si funksion thelbësor të këtij institucioni me impakt të drejtpërdrejtë në rritjen e transparencës dhe efektivitetit të sistemit të drejtësisë, duke iu përgjigjur nevojave të publikut për një sistem drejtësie të pavarur, eficient dhe të paanshëm.

magjistratëve, i cili është një mekanizëm i spektorit të Lartë të Drejtësisë i ka rëndësishëm dhe i domosdoshëm në një vlerësuar inspektimet tematike dhe institucioneve tona, nga modeli i organeve të inspektimit të fokusuar në vlerësimin individual të gjyqtarëve dhe prokurorëve (*magistrate-based inspections*) drejt paanshëm.

vlerësimit të cilësisë dhe performancës së sistemit gjyqësor në tërësi, përmes një modeli të bazuar në inspektimin e gjykatave dhe prokurorive (*institution-based inspections*).

Nevoja për këtë qasje të re është e rëndësishme për dy arsye: Pikësëpari, dhënia e drejtësisë është një shërbim publik me impakt të thellë në një shoqëri, por në shumë raste jo në cilësinë apo eficientë e duhur, duke mos kryer funksionin apo qëllimin e saj. Në të njëjtën kohë, mosfunksionimi i saj ka ndikuar dhe në veprimtarinë dhe performancën e magjistratëve, të cilët shpeshherë përballen me ngarkesa dhe kushte pune, të cilat jo vetëm kanë ndikuar në aftësinë profesionale, aftësitë e komunikimit, kujdesin profesional, efikasitetin apo integritetin e tyre, por njëkohësisht edhe në cilësinë e drejtësisë së ofruar.

Në frymën e kësaj qasjeje, Zyra e In-

Synimi primar i inspektimeve tematike, të përfunduara dhe në proces nuk ka qenë identifikimi i dështimeve në sistem apo konstatimi i shkeljeve konkrete disiplinore nga magjistratët apo iniciimi i procedimeve disiplinore, pasi ILD parapakisht vlerëson se një sërë çështjesh mund të kërkojnë një adresim të qartë dhe zgjidhje të kujdesshme, në aspekt *sistemik* dhe nuk mund të adresohen vetëm nga ana e Zyrës së ILD-së, në kuadër të procedimeve disiplinore për sa pretendohet vazhdimisht, mbi rolin dhe funksionet e institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

Përkundrazi inspektimet tematike të realizuara kanë patur si fokus kryesor konstatimin e problematikave në sistemin e drejtësisë dhe rekomandimin e zgjidhjeve, të cilat pritet t'i shërbejnë përmirësimit të punës së prokurorive dhe gjykatave. Rekomandimet e dala në përfundim të këtyre inspektimeve i kanë shërbyer

përmirësimit të funksionalitetit të gjykatave dhe zyrave të prokurorive në shërbim të dhënies së drejtësisë ndaj publikut.

Të nderuar kolegë,

Në një kohë kur pritshmëritë e publikut janë të larta dhe sfidat në rritje, detyra jonë e përbashkët është të ndërtojmë një kulturë të vlerësimit të drejtë dhe objektiv, të funksionimit të pushtetit gjyqësor, si dhe punës së magjistratëve. Në këtë aspekt vlen të theksohet se inspektimet tematike apo institucionale janë një nga mekanizmat më efektivë për ta bërë këtë objektiv realitet.

Ky është një proces kompleks dhe nuk mund të jetë vetëm objekt i veprimtarisë së Zyrës së ILD-së. Bashkëveprimi dhe bashkërendimi ndërmjet institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në identifikimin e çështjeve që afektojnë sistemin e drejtësisë dhe që duhet t'i nënshtrohen

inspektimit është i qenësishëm. Në këtë aspekt bashkëveprimi dhe koordinimi ndërmjet institucioneve tona është i nevojshëm, jo vetëm në paraqitjen e propozimeve për kryerjen e inspektimeve tematike, por në vijimësi në fushat me impakt në veprimtarinë e magjistratëve.

Ky proces kërkon pikësëpari një vizion të qartë strategjik të të gjithë institucioneve tona mbi rëndësinë e zhvillimit të inspektimeve tematike apo institucionale. Kërkon një plan të mirëfilltë implementimi dhe zbatimi, apo një proces strikt monitorimi dhe zbatimi të rekomandimeve.

Në këtë kuadër, e vlerësoj aktivitetin e sotëm dhe besoj se ky do jetë vetëm fillimi i një procesi të gjatë bashkëpunimi në këtë drejtim, me qëllim angazhimin e të gjitha institucioneve tona për ndërtimin e një sistemi drejtësie, i cili i shërben në mënyrë dinjitoze qytetarëve dhe shoqërisë tonë.

Faleminderit!



**REFERIM I INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË:
SITUATA AKTUALE E INSPEKTIMEVE TEMATIKE,
KËNDVËSHTRIMI HISTORIK, BASHKËPUNIMI
NDËRINSTITUCIONAL, GJETJET KRYESORE
DHE REKOMANDIMET**

Inspektori i Lartë i Drejtësisë përmes mekanizmeve të inspektimeve tematike, është aktiv në sistemin e kontrollit të punës së magjistratëve, duke përcaktuar standarde për një sistem drejtësie llogaridhënës, të përgjegjshëm, të paanshëm dhe me integritet.

Përmirësimi i vazhdueshëm i proceseve të punës dhe vënia në funksion e mekanizmeve të reja për mbledhjen e informacioneve në funksion të adresimit të tematikave të inspektimit kanë shërbyer në rritjen e numrit të inspektimeve, por edhe të adresimit të çështjeve që sot janë shqetësimi i publikut. Më konkretisht, Inspektori i Lartë i Drejtësisë:

- Ka ngritur mekanizmin administrativ të monitorimit të veprimtarisë së magjistratëve përmes marrjes së informacionit periodik nga gjykatat dhe prokuroritë. Këto informacione periodike shërbejnë për evidentimin e fenomeneve që lidhen me cilësinë dhe efikasitetin e sistemit, të cilat janë përfshirë në tematika inspektimi.
- Ky mekanizëm konsiderohet si prioritar në evidentimin e problematikave të sistemit, të cilat përbëjnë objekt të inspektimeve tematike. Këtu vlen të theksojmë nevojën për harmonizimin e të dhënave që gjykatat dhe zyrat e prokurorive paraqesin pranë Këshillave dhe Prokurorit të Përgjithshëm. Ky koordinim dhe harmonizim i mënyrës së rapor-



Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka siguruar jo vetëm përgjegjësinë e magjistratëve, duke hetuar shkeljet e dyshuara, por edhe adreson sistemin gjyqësor me rekomandime për masa të karakterit rregullator, të karakterit administrativ dhe institucional për t'u ndjekur nga subjektet e inspektimit, si dhe organet e tjera që kanë funksione qeverisëse ndaj sistemit.

timit është i nevojshëm për rritjen e efijencës në mënyrën e raportimit të të dhënave statistikore duke ulur edhe barrën e këtyre institucioneve për të raportuar në formate të ndryshme përpara disa institucioneve.

- Pjesëmarrja në analizën vjetore të gjykatave duke u njohur nga afër me sfidat e sistemit gjatë vitit.
- Pjesëmarrja në takime pune me këshillat për të diskutuar dhe forcuar bashkëpunimin përmes propozimeve me tematika.

Nga veprimtaria e inspektimeve te-

matike dhe institucionale Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka siguruar jo vetëm përgjegjësinë e magjistratëve, duke hetuar shkeljet e dyshuara, por edhe adreson sistemin gjyqësor me rekomandime për masa të karakterit rregullator, të karakterit administrativ dhe institucional për t'u ndjekur nga subjektet e inspektimit, si dhe organet e tjera që kanë funksione qeverisëse ndaj sistemit. Rekomandimet e lëna nuk kanë natyrë penalizuese, por synojnë të adresojnë në mënyrë sistematike problematikat me të cilat përballlet sistemi i drejtësisë sot.



Inspektimet tematike kanë nxjerrë në pah edhe veprime apo mosveprime të magistratëve, ndaj të cilëve Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar verifikimin, rezultatet e të cilit kanë çuar në përgjegjësi disiplinore për disa magistratë dhe vijon puna për verifikimin e rasteve të tjera.

Përgjatë periudhës Shkurt 2020 – Prill 2025, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka zhvilluar 10 inspektime tematike pranë gjykatave si dhe zyra të prokurorisë. Në total janë propozuar 108 rekomandime të cilat janë adresuar subjekteve të inspektimeve por edhe organeve të tjera.

ILD, përveç rekomandimeve të lëna për subjektet e inspektimit ka dhënë rekomandime edhe për organe të tjera, veprimtaria e të cilave ndikon në performancën e sistemit gjyqësor, siç janë masat për:

- Propozim për ndryshime të akteve apo nxjerrjen e tyre;
- Ndryshim të praktikës administrative të ndjekur duke propozuar masa për veprime administrative;
- Fuqizim të kapaciteteve të burimeve njerëzore duke propozuar ndjekjen e tematikave të caktuara në formimin vazhdues të magistratëve. Disa metoda në aspektin administrativ mund të zbatohen nga vetë gjykatat për të nxitur përkohësisht përsheptimin e gjykimit të çështjeve.

Inspektimet tematike kanë nxjerrë në pah edhe veprime apo mosveprime të magistratëve, ndaj të cilëve Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar verifikimin, rezultatet e të cilit kanë çuar në përgjegjësi

disiplinore për disa magistratë dhe vijon puna për verifikimin e rasteve të tjera. Në vijim po japim një panoramë dhe një përmblendje të disa prej inspektimeve tematike të realizuara nga ana e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

a. Në fillimet e ushtrimit të veprimtarisë funksionale ILD ka vendosur kryerjen e inspektimit tematik *“Për lirimet para kohe me kusht”*. Ky inspektim i filluar në vitin 2020 ka trajtuar kërkesat për *“Lirim me kusht”* nga ana e gjykatave të rretheve gjyqësore, gjykatave të apelit si dhe zyrave të prokurorive pranë tyre, në lidhje me zbatimin e ligjit material dhe procedural penal në fuqi. Inspektimi ka sjellë efekte të ndjeshme në kuadër të llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së magistratëve.

Gjatë kryerjes së tij, janë hetuar dhe proceduar disiplinarisht disa magistratë, ndaj të cilëve Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë, ka caktuar masa disiplinore të shkarkimit nga detyra. Këto masa disiplinore janë lënë në fuqi edhe nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, me vendim marrje përfundimtare duke konfirmuar kështu standardin e punës së Zyrës së ILD-së. Përveç këtij rezultati në drejtim të identifikimit të përgjegjësi individuale të magistratëve, ka patur një efekt të konstatuar në drejtim të përdorimit më të kujdesshëm të institutit të *“lirimit me kusht”* dhe rritje të cilësisë së vendimmarrjes. Në



përfundim të inspektimit janë hartuar disa rekomandime të karakterit normativ, rregullator dhe administrativ për prokuroritë dhe gjykatat përkatëse subjekt inspektimi, Gjykatën e Lartë, Prokurorin e Përgjithshëm, Këshillin e Lartë Gjyqësor, Këshillin e Lartë të Prokurorisë dhe Shkollën e Magjistraturës dhe njëkohësisht janë iniciuar edhe verifikime kryesisht për faktet që kanë rezultuar në përfundim të këtij inspektimi.

b. Inspektimi me objekt: *“Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, (Dhoma Civile) dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë”*, për periudhën 01.09.2022-30.12.2022. Duke marrë në konsideratë ngarkesën mesatare të një gjyqtari në Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë me 1361 çështje dhe dorëzimin e vendimeve të

shpallura në sekretari rezultoi se 89 % e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 120 ditë, duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit për dorëzimin e vendimit përfundimtar të arsyetuar. Nëpërmjet këtij inspektimi tematik, ILD ka bërë një fotografim të situatës së dorëzimit të vendimeve gjyqësore nga Dhoma Civile e Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë.

Afati 120 ditë rezultoi si koha e arsyeshme që i nevojitet magjistratit të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, pasi vetëm ky afat mund të bëjë dallimin, si dhe të shërbejë si një kohë e arsyeshme në situatën konkrete të ngarkesës, organikës dhe numrit të magjistratëve, apo tipologjisë së çështjeve të gjykuara, mes nevojës për të arsyetuar dhe dorëzuar të gjitha vendimet gjyqësore sipas afatit të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile dhe mundësisë dhe ka-

paciteteve aktuale të Gjykatës së e të kryer gjatë vitit 2024, i janë nënshtruar Shkallës së Parë Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të respektuar këtë afat. Ky afat nuk zëvendëson në asnjë rast afatin ligjor, por përbën një konstatim nga ILD në momentin e kryerjes së inspektimit, në atë gjykatë, për të vlerësuar ndërmarrjen e nismave të mëtejshme të verifikimit apo hetimit disiplinor për magjistratët që nuk e kanë ndjekur këtë afat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Vlen të theksojmë se ngarkesa nuk mund të përdoret për të justifikuar vonesat, të cilat tejkalojnë çdo afat të logjikshëm në arsyetimin e vendimit pasi në këtë rast do të cenohej thelbi i të drejtës kushtetuese për një proces të rregullt ligjor dhe nocioni i dhënies së një drejtësie të pavarur dhe të paanshme do të humbiste thelbin e saj. Rezultatet e këtij inspektimi tematik kanë shërbyer për iniciimin e hetimit dhe procedimit disiplinor ndaj një magjistrati i cili është konkluduar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor me një vendimmarrje për rrëzimin e kërkesës për masë disiplinore.

c. Vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësor si një element që prek thelbin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor kanë qënë në vëmendje të ILD në mënyrë të vazhdueshme. Me inspektimin tematik

inspektimit dy gjykata të tjera, respektivisht Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023.

Nga të dhënat e marra nga ky inspektim rezulton se, për Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Fier 97.8% e vendimeve janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor, për Gjykatën e Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Shkodër 80.2% e vendimeve civile janë dorëzuar brenda afatit 60 ditor duke u konsideruar kështu në shumicën e rasteve, si koha e arsyeshme që i nevojitet gjyqtarit për dorëzimin e vendimit përfundimtar të arsyetuar. Edhe në këtë rast afati 60 ditor është vlerësuar si një afat i arsyeshëm në kushtet e situatës konkrete të ngarkesës dhe vakancave në gjykatat respektive dhe një balancë e proporcionale ndërmjet përmbushjes së detyrimit ligjor nga njëra anë dhe kapaciteteve aktuale të gjykatave subjekt inspektimi.

Nga ana tjetër, ky afat nuk zëvendëson në asnjë rast afatin ligjor por përbën një konstatim nga ILD në momentin e kryerjes së inspektimit, në atë gjykatë, për të vlerësuar ndërmarrjen e nismave të mëtejshme të verifikimit apo hetimit

Vonesat në arsyetimin e vendimeve gjyqësor si një element që prek thelbin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor kanë qënë në vëmendje të ILD në mënyrë të vazhdueshme. Me inspektimin tematik të kryer gjatë vitit 2024, i janë nënshtruar inspektimit dy gjykata të tjera, respektivisht Gjykatat e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Fier dhe Shkodër, për periudhën 01.01.2023-01.06.2023.



disiplinor për magistratët që nuk e kanë ndjekur këtë afat në arsyetimin e vendimeve gjyqësore.

Gjetjet e këtij inspektimi tematik janë në proces verifikimi nga ILD rast pas rasti, për të vlerësuar nëse ka elementë faktikë dhe juridikë për të filluar hetimin disiplinor kryesisht.

d. Tematikë tjetër e rëndësishme e përfshirë në planin e inspektimeve për vitin 2024, është edhe informimi i palëve nga gjykata për të drejtën e zgjidhjes së çështjeve me ndërmjetësim. Kjo tematikë është përfshirë si një masë në kuadër të procesit të integritetit dhe udhërrëfyesit për shtetin e së drejtës për këtë qëllim. Ky inspektim tematik është shtrirë në katër gjykata, respektivisht Gjykatat e Juridiksionit të Përgjithshëm të Shkallës së Parë Tiranë, Durrës, Vlorë dhe Elbasan. Në përfundim të këtyre Inspektimeve ILD

ka rekomanduar përdorimin e një qasjeje proaktive nga gjykata, për njoftimin dhe udhëzimin e palëve për mundësinë e zgjidhjes së çështjes me ndërmjetësim, duke dhënë informacion të plotë mbi llojin e procesit dhe përfitimet procedurale dhe kohore që kanë palët si një mekanizëm për rritjen e efikasitetit të drejtësisë, përshpejtimin e gjykimit të çështjeve dhe uljen e backlogut në gjykata.

e. Në përcaktimin e tematikave të inspektimit një rol të rëndësishëm luan përmbushja e detyrimeve ligjore të parashikuara nga kuadri rregullator në fuqi. Konkretisht inspektimet tematike në lidhje me:

- Ndarjen e çështjeve me short, si dhe kontrolli elektronik i raporteve të sistemit elektronik;

Në funksion të rekomandimit të lënë në Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, në planin vjetor të inspektimeve për vitin 2025, është vendosur kryerja e një inspektimi institucional, me objekt kontrollin e aspekteve specifike të veprimtarisë në administrimin e dokumentacionit nga momenti i regjistrimit në sekretari e deri në përfundimin e trajtimit të tij.

- “Mbi praktikën dhe shkaqet e zëvendësimit të prokurorëve; në transparencën dhe garantimin e pavarësisë në prokuroritë me juridiksion të përgjithshëm”, i ndryshuar. Ky inspektim ka patur qëllim zbatimin e urdhrave të Prokurorit të Përgjithshëm, mbi ruajtjen e qëndrueshmërisë së organit të prokurorisë përmes kohezionit institucional dhe uniformitetit të veprimtarisë në të gjitha prokuroritë, në garantimin e pavarësisë funksionale të prokurorit në vendimmarrje për çështje konkrete.
- “Mbi caktimin e çështjeve në prokurori. Ky inspektim vlerësohet të vijohet edhe në vazhdim pasi nga monitorimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna, por edhe nga verifikimet e kryera në kuadër të procesit të shqyrtimit të ankesave janë konstatuar përsëri problematika.
- Janë inspektime, të cilat duhet të realizohen çdo vit nga ILD në kuadër të respektimit të parashikimeve ligjore.

Në përfundim të këtyre inspektimeve janë lënë rekomandime:

i. të natyrës rregullatore: ku përfshihen rekomandime për nxjerrjen e akteve nënligjore nga kryetarët e gjykatave apo drejtuesit e prokurorive;

ii. administrative, ku përfshihen vlerësime mbi aspekte të efijencës së veprimtarisë; procedurat e brendshme të punës; shpërndarja e punës; respektimi i etikës; disiplina; marrëdhënia me palët/publikun; sistemet elektronike,

iii. disiplinore, ku përfshihen verifikime mbi veprime apo mosveprime të magjistratëve që japin shkak verifikimit apo edhe hetimit disiplinor.

f. Inspektimi me objekt: “Mbi marrjen e masave administrative dhe procedurale në kuadër të zbatimit të udhëzimit të përgjithshëm nr. 12, datë 20.07.2020, të Prokurorit të Përgjithshëm “Mbi rregullimin e marrëdhënieve mes prokurorëve dhe drejtuesve të prokurorisë, informimin,

g. Nga të dhënat e administruara në kuadër të shqyrtimit të pretendimeve të ankesave, me iniciativë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, është vendosur kryerja e një inspektimi tematik mbi kohëzgjatjen e gjykimit të çështjeve gjyqësore, duke pasur në vëmendje çështje të rritjes së cilësisë dhe efijencës së sistemit gjyqësor, si prioritet ndaj pretendimeve të publikut. Ky inspektim është vendosur të kryhet pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë dhe aktualisht është në fazën e konkludimit të tij me rekomandime konkrete.

Mekanizmi i kontrollit të llogaridhënies ndaj sistemit të drejtësisë është duke funksionuar, me standarde të ngritura dhe të konfirmuara, pa përjashtuar këtu edhe nevojën për fuqizim dhe përmirësim të vazhdueshëm, duke rritur cilësinë dhe efikasitetin e sistemit, ndaj individit dhe shtetit të së drejtës.

h. Në funksion të rekomandimit të lënë në meve është një proces që kërkon Rezolutën e Kuvendit të Shqipërisë, në përpjekje të vazhdueshme dhe rritje planin vjetor të inspektimeve për vitin profesionale si në nivelin e burimeve 2025, është vendosur kryerja e një in- njerëzore ashtu edhe në ngritjen e ka- spektimi institucional, me objekt kontrollin paciteteve, për të cilat Inspektori i Lartë i e aspekteve specifike të veprimtarisë në Drejtësisë, synon t'i përmirësojë në të administrimin e dokumentacionit nga mo- ardhmen në harmoni me praktikat më të menti i regjistrimit në sekretari e deri në mira evropiane në këtë drejtim. përfundimin e trajtimit të tij. Ky inspektim

është vendosur të kryhet në Prokurorinë Si konkluzion, nga të dhënat e mësipërme pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Ju- rezulton se mekanizmi i kontrollit të lloga- ridiksionit të Përgjithshëm Diber dhe aktu- ridhënies ndaj sistemit të drejtësisë është alisht është në fazën e mbledhjes së të duke funksionuar, me standarde të ngritu- ra dhe të konfirmuara, pa përjashtuar këtu dhënave. edhe nevojën për fuqizim dhe përmirësim

Ndjekja e zbatimit të rekomandimeve të të vazhdueshëm, duke rritur cilësinë dhe lëna sigurohet nga Inspektori i Lartë i efikasitetin e sistemit, ndaj individit dhe Drejtësisë nëpërmjet mekanizmit moni- shtetit të së drejtës.

torues të zbatimit të rekomandimeve të të vazhdueshëm, duke rritur cilësinë dhe Nxjerra. Monitorimi kryhet nëpërmjet e efikasitetin e sistemit, ndaj individit dhe marrjes së informacionit nga organet e Drejtësisë po synon hartimin e një metod- ologjie pune që do të rregullojë monitori- inspektuara dhe vlerësimit të informacio- min e zbatimit të këtyre rekomandimeve. nit të marrë. Në këtë aspekt, kontributi dhe asistenca e

Monitorimi i zbatimit të rekomandimeve projektit EUIVJustice me praktikat dhe përbën një sfidë edhe për Inspektorin e standardet më të mira evropiane në drafti- Lartë të Drejtësisë, pasi çdo inspektim kër- min e kësaj metodologjie përbën një vlerë kon një nivel të lartë të përfshirjes së buri- të shtuar. meve njerëzore, përballë thirrjes për

Faleminderit



METANI: VËMENDJA INSTITUCIONALE PËR MEDIAT DUHET JO PËR TË QENË MIQ ME GAZETARËT, POR ME LIRINË E SHPREHJES

Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani mori pjesë në tryezën e rrumbullakët “Përmirësimi i Sigurisë dhe Mbrojtjes së Gazetarëve. Ndarja e praktikave më të mira dhe përballimi i sfidave të vazhdueshme”, organizuar nga Këshilli i Evropës dhe Bashkimi Evropian në kuadër të projektit

Zoti Metani ishte pjesë e panelit të institucioneve ku u diskutua mbi “Sfidat dhe zgjidhjet për autoritetet vendase për të përmbushur standardet ndërkombëtare për mbrojtjen e gazetarëve.”

Në fjalën e tij, zoti Metani vlerësoi mënyrën e organizimit të takimit, duke bërë bashkë mediat dhe institucionet, me emërues të përbashkët komunikimin dhe interesin publik.

“Patjetër, që edhe mund të mos bihet dakord për gjithçka, por është shumë e rëndësishme të komunikohet, duke adresuar shqetësimet në institucione, por edhe përmes takimeve e tryezave, që ndihmojnë edhe informimin reciprok mbi problematika të caktuara. Dhe duke mbajtur në konsideratë parimet kushtetuese mbi të cilat organizohet e gjithë jeta jonë profesionale dhe jo vetëm, besoj se gjendja



e zgjidhjeve bëhet më e shpejtë dhe në mënyrë më efikase”, tha zoti Metani.

Në fjalën e tij z. Metani referoi statistika të ndërveprimit të mediave me ILD në 5 vitet e funksionimit të institucionit, si iniciuese të verifikimeve kryesisht, si ankuese dhe si informuese e opinionit publik.

“Në 5 vite funksionim, ka pasur edhe indicie të sakta të marra nga mediat, mbi të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar kryesisht 12 hetime disiplinore. Këto 12 hetime kanë filluar për 13 subjekte: 6 gjyqtarë, 6 prokurorë dhe 1 anëtar Këshilli. 11 magjistratë janë dërguar nga ILD për procedim disiplinor në KLGJ e KLP dhe për 2 magjistratë të tjerë, hetimi disiplinor është mbyllur. Nga 11 magjistratët e dërguar për procedim disiplinor, në 7 raste ILD ka kërkuar

masën disiplinore “Shkarkim nga anton punën e gazetarëve dhe duke iu detyra”. Këshillat kanë pranuar kërkesën e ILD në 5 raste, pra magjistratët janë shkarkuar. Për një rast kanë vendosur “pezullim nga detyra për një periudhë prej 6 muajsh”, ndërsa rasti tjetër është i pezulluar, pasi pritet vendimmarrja e KPA. Në 4 raste, ILD ka kërkuar masën disiplinore “Vërejtje publike” në Këshilla. 1 rast është pranuar dhe 3 të tjera janë rrëzuar. Në 5 vitet e funksionimit të ILD-së, mediat vetë kanë referuar 17 ankesa për shkelje disiplinore. Për to, ILD ka marrë 11 vendime përfundimi konkretisht: 2 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, 7 pas verifikimit, 2 pasi është kryer hetim disiplinor. 6 ankesa të tjera janë në proces shqyrtimi.

Duke patur në konsideratë faktin se krijimi i kushteve për të marrë informacionin e kërkuar është një tjetër element, që gar-

referuar statistikave tona, media ka ndërvepruar direkt me ILD-në përmes kërkesave për informacion në 46 raste. Vetëm në 6 prej tyre, informacioni ka qenë i kufizuar sipas ligjit dhe kjo është shpjeguar qartësisht. Konstatohet me kënaqësi që në raport me ILD-në, mediat respektojnë parimin ligjor të konfidencialitetit të veprimeve hetimore, që fillojnë me shqyrtimin fillestar apo veprimet paraprake hetimore për sjellje/shkelje të dyshuara nga gjyqtarët, pasi ky konfidencialitet i shërben mbrojtjes së integritetit të procesit dhe reputacionit të magjistratit, nëse akuzat rezultojnë të pabazuara.” u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë Metani.

FJALA E PLOTË E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË Z. ARTUR METANI

Të nderuar të pranishëm,

Duke ju falënderuar së pari për ftesën në këtë aktivitet, dua ta nis fjalën me një vlerësim të madh për tryeza diskutimi me tema të tilla. Jo thjesht sepse liria e shprehjes, e shtypit dhe e medias mbetet në themel të një shoqërie të lirë, por sepse gjendja e vlerave shoqërore sot, kudo dhe në Shqipëri, ka nevojë për diskutim të vazhdueshëm dhe për reflektim të singertë të gjithkujt prej nesh, duke e parë si një kontribut për konsolidimin demokratik të shoqërisë në vitet që vijnë dhe jo si një debat të ditës. E në këtë kuptim, takimin mes gazetarëve dhe institucioneve e shoh si një mundësi të mirë për të ndarë, se çfarë mund të bëjmë më shumë dhe më mirë për rritjen e sigurisë për gazetarët.

Patjetër, që edhe mund të mos bihet dakord për gjithçka, por është shumë e rëndësishme të komunikohet, duke



adresuar shqetësimet në institucione, por mjedis të sigurt pune për gazetarët nuk edhe përmes takimeve e tryezave, që duhet parë thjesht në nivelin e respektimit ndihmojnë edhe informimin reciprok mbi të konventave ndërkombëtare apo edhe të problematika të caktuara. Dhe duke mbajtur në konsideratë parimet kushtetuese mbi të cilat organizohet e gjithë jeta jonë profesionale dhe jo vetëm, besoj se gjendja e zgjidhjeve bëhet më e shpejtë dhe në mënyrë më efikase.

Ndoqa me shumë interes prezantimet e panelit të parë mbi situatën e gazetarëve, lidhur me kushtet në të cilat ushtrojnë detyrën dhe dua të përgëzoj secilin nga folësit për panoramën që na dha. Është informacion parësor, por edhe me ndjeshmëri personale, të cilin nuk e gjen dot në debatin e përditshëm publik dhe si i tillë ka vlerë të veçantë.

Personalisht mendoj se angazhimi për një

akoma më të rëndë për të ardhmen. Natyrisht, ndër të parat institucione publike që luajnë një rol themelor në mbrojtjen e gazetarëve dhe promovimin e lirisë së medias janë institucionet e drejtësisë, që kanë një rol të posaçëm. Reagimi me vendosmëri kundër krimeve të kryera ndaj gazetarëve, që nisin nga stigmatizimi, sulmet, kërcënimet, apo më keq, vrasjet, që fatmirësisht nuk është rasti i Shqipërisë,



është një detyrë sa institucionale aq edhe njerëzore. Pra, institucionet duhet të ushtrjnë detyrën e tyre, por nga ana tjetër, duhet edhe të kenë ndjeshmërinë e lartë për vlerat shumë specifike të shoqërisë, që përfaqësojnë mediat.

Secili nga ne e ka të qartë se çdo kategori dhe vlerë shoqërore është e barabartë para ligjit, por secili nga ne, në të përditshmen e vet, mund ta ketë në vëmendje të posaçme një kategori si media dhe jo për të qenë miq me gazetarët, por për të qenë miq me lirinë e shprehjes, me vëmendje për gazetarët, si për specifikën e punës, ashtu edhe për ç'ka përfaqëson në shoqëri, zërin e publikut. Është një praktikë që ne e ndjekim në zyrën e ILD-së, pra vëmendje të shtuar kur kemi marrëdhënie me gazetarët dhe në kuadër të kësaj tryeze të rrumbullakët,

pata mundësi të shoh statistikat e ndërveprimit të medias me Inspektorin e Lartë të Drejtësisë, të cilat do ua sjell në tre dimensione: si informuese publike, ankuese apo edhe e angazhuar direkt, përmes kërkesave për informacion drejtuar institucionit tonë.

Siç e thashë, në ILD përpiqemi ta trajtojmë median si kategori në vëmendje të posaçme. Nuk është e thjeshtë, sepse institucioni ka mungesa në burime njerëzore, sa i takon inspektimit disiplinor, por në këto 5 vite veprimtari jemi përpjekur të bëjmë më të mirën, duke respektuar të drejtën e publikut për t'u informuar mbi mënyrën sesi administrohet drejtësia në vend, kërkesë që vjen përmes medias, pasi natyrshëm, edhe informimi i medias nga institucionet bën pjesë te siguria e gazetarëve për të





ushtruar lirisht misionin e tyre.

Në 5 vite ka pasur vetëm një rast nga një gazetarë, që iu drejtua Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesë për pengim në ushtrimin e detyrës, për shkak të mbylljes së dyerve për median gjatë një seance gjyqësore (ishte periudha e Covid-it). Rasti u verifikua nga inspektorët e ILD-së dhe u arkivua, sepse nuk kishte fakte të mjaftueshme për të justifikuar fillimin e procedimit disiplinor.

Por, inspektorët e ILD-së evidentuan në vendim, se edhe pse në këtë rast nuk ka vend për përgjegjësi disiplinore, në kuptim të ligjit 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, Inspektori i Lartë i Drejtësisë e gjen me vend të theksojë rëndësinë që ka

krijimë gazetarëve për të kryer detyrën e tyre, ne garantojmë jo thjesht gazetarët, por misionin e tyre, të drejtën e shoqërisë për të pasur mundësinë për të gjykuar qeverisjen, në çdo dimension të saj, përfshi pushtetin gjyqësor.

Shoqëria është dhe duhet të jetë ajo që vlerëson nëse puna e sistemit të drejtësisë apo një raportim mediatik i caktuar është korrekt dhe jo institucionet, duke kufizuar informacionin. Kjo, pasi krijimi i respektit për punën e sistemit të drejtësisë është një përpjekje që shkon përtej sistemit. Ai është edhe kontribut i faktorëve të tjerë në shoqëri, veçanërisht atyre mediatikë, si ndërlidhës të rëndësishëm me opinionin publik, pra me shoqërinë.

Nga ana tjetër, e konsideroj të rëndësishme adresimin tek institucioni dhe njohjen e kompetencave të tij. Tek Inspektori i Lartë i



Drejtësisë mund të ankoheni për veprime ose mosveprime, të cilat përbëjnë mospërbushje të detyrës, apo sjellje joprofesionale ose joetike gjatë ushtrimit të funksionit apo jashtë tij, të cilat diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve në Republikën e Shqipërisë.

Këtë e parashikon ligji dhe si institucion e kemi lehtësuar në vijimësi procesin e ankimit. Mjafton të hyhet te faqja e internetit **ild.al** dhe ekziston opsioni i ankesës online, që mund të bëhet edhe përmes celularit, për fare pak minuta.

Nga ana tjetër, mediat vizive, ato të shkruara por edhe mediat e reja, kanë qenë përmes informacioneve të dhëna publikisht, iniciuese të verifikimeve, që kanë çuar në hetime e madje edhe procedime disiplinore ndaj gjyqtarëve e pro-

kurorëve, prej vitit 2020 kur ka nisur nga puna Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Natyrisht, ka pasur raste kur denoncimet nuk kanë përbërë shkelje sipas ligjit.

Të tilla kanë rezultuar 9 raste, kur ILD ka nisur verifikimin me iniciativë të informacioneve të bëra publike në median e shkruar dhe atë vizive. ILD ka verifikuar 14 magjistratë, 6 gjyqtarë dhe 8 prokurorë, duke marrë 9 vendime arkivimi.

Siç e bëjmë të qartë në komunikimet tona publike, veprimet apo mosveprimet e magjistratit, të cilat mund të përbëjnë shkelje disiplinore, sipas kërkesave të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, nuk janë vetëm ato që parashtrihen në bazë të një informacioni publik, por janë ato që analizohen nga In-

spektori i Lartë i Drejtësisë, apo vlerësohen në bazë të një procesi verifikimi apo hetimi disiplinor.

Në bazë të një informacioni publik mund të paraqiten një tërësi faktesh, të cilat pretendohet se kanë ndodhur dhe që përbëjnë shkelje disiplinore, por Inspektori i Lartë i Drejtësisë mund të bëjë një cilësim të saktë apo të ndryshëm të fakteve dhe veprimeve, që lidhen me shkeljen disiplinore, pa u lidhur me përcaktimin që mund të pretendohet në këtë informacion publik.

Por në 5 vite funksionim, ka pasur edhe indicie të sakta të marra nga mediat, bazuar në të cilat Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka filluar kryesisht 12 hetime disiplinore. Këto 12 hetime kanë filluar për 13 subjekte: 6 gjyqtarë, 6 prokurorë dhe 1 anëtar Këshilli. 11 magjistratë janë dërguar nga ILD për procedim disiplinor në KLGJ e KLP dhe për 2 magjistratë të tjerë, hetimi disiplinor është mbyllur.

Nga 11 magjistratët e dërguar për procedim disiplinor, në 7 raste ILD ka kërkuar masën disiplinore "Shkarkim nga detyra". Këshillat kanë pranuar kërkesën e ILD në 5 raste, pra magjistratët janë shkarkuar. Për

një rast kanë vendosur "pezullim nga detyra për një periudhë prej 6 muajsh", ndërsa rasti tjetër është i pezulluar, pasi pritet vendimmarrja e KPA. Në 4 raste, ILD ka kërkuar masën disiplinore "Vërejtje publike" në Këshilla. 1 rast është pranuar dhe 3 të tjera janë rrëzuar. Në 5 vitet e funksionimit të ILD-së, mediat vetë kanë referuar 17 ankesa për shkelje disiplinore. Për to, ILD ka marrë 11 vendime përfundimi konkretisht: 2 janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar, 7 pas verifikimit, 2 pasi është kryer hetim disiplinor. 6 ankesa të tjera janë në proces shqyrtimi.

Duke patur në konsideratë faktin se krijimi i kushteve për të marrë informacionin e kërkuar është një tjetër element, që garanton punën e gazetarëve dhe duke iu referuar statistikave tona, media ka ndërvepruar direkt me ILD-në përmes kërkesave për informacion në 46 raste. Vetëm në 6 prej tyre, informacioni ka qenë i kufizuar sipas ligjit dhe kjo është shpjeguar qartësisht. Konstatohet me kënaqësi që në raport me ILD-në, mediat respektojnë parimin ligjor të konfidencialitetit të veprimeve hetimore, që fillojnë me shqyrtimin fillestar apo veprimet paraprake hetimore për sjellje/shkelje të dyshuara nga gjyqtarët, pasi ky konfidencialitet i shërben mbrojtjes së integritetit të procesit dhe

Mediat respektojnë parimin ligjor të konfidencialitetit të veprimeve hetimore, që fillojnë me shqyrtimin fillestar apo veprimet paraprake hetimore për sjellje/shkelje të dyshuara nga gjyqtarët, pasi ky konfidencialitet i shërben mbrojtjes së integritetit të procesit dhe reputacionit të magjistratit, nëse akuzat rezultojnë të pabazuara.



reputacionit të magjistratit, nëse akuzat rezultojnë të pabazuara.

Në 5 vite, ILD i ka dhënë përparësi absolute transparencës ndaj publikut, si mjeti që ndihmon në forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, por duke ruajtur balancën e nevojshme mes interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve. Pasi, të dy këto pushtete gjejnë mbrojtje në Kushtetutë, asnjë me epërsi ndaj tjetrit, por me profile të

qarta dhe të ndara në një shoqëri demokratike. Këtu sërish e nënvizoj si jetik, siç e thashë më sipër, komunikimin mes mediave e institucioneve. Një angazhim i fortë i të gjithë aktorëve publikë, përmes një dialogu sistematik, jo vetëm për të monitoruar çfarë ndodh e reagu shpejt, por edhe për t'u informuar e informuar publikun për kontributin, që duhet të japim të gjithë për një mjedis të sigurt për mediat.

Ju faleminderit!

Në 5 vite, ILD i ka dhënë përparësi absolute transparencës ndaj publikut, si mjeti që ndihmon në forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, por duke ruajtur balancën e nevojshme mes interesit publik për administrimin e drejtësisë dhe respektimit të pavarësisë së magjistratëve.



TRAJNIMI I VAZHDUESHËM, SI FILOZOFI PUNE PËR RRITJEN E EFIKASITETIT TË NJËSIVE TË INSPEKTIMIT NË ILD

Njësia e inspektorëve dhe ajo e ndihmësinspektorëve të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë zhvilluan një trajnim treditör mbi fazat specifike të realizimit të inspektimeve tematike dhe institucionale.

I realizuar nga dy ekspertë ndërkombëtarë afatshkurtër, prokurorja María del Carmen de la Fuente Méndez, inspektore pranë Inspektoratit të Përgjithshëm të Drejtësisë në Spanjë dhe prokurorja Maria Nieves Pujal, drejtuese në prokurorinë e Barcelonës, me mbështetjen e EU4Justice, trajnimi u bazua në modelet e punës së ILD-së dhe praktikat më të mira të Spanjës dhe vendeve BE-së. “Ky trajnim bëhet në kuadër të inspektimeve tematike, por kam insistuar që të zhvillohet më shumë si një krahasim eksperiencash dhe praktikash pune mes Shqipërisë dhe Spanjës”, u shpreh Inspektori i Lartë i Drejtësisë z. Artur Metani në fjalën përshëndetëse, duke

nënvizuar rëndësinë që institucioni që drejton i jep trajnimit të vazhdueshëm të ekipit, për forcimin e kapaciteteve dhe përditësimin me modelet e standardet më të mira të punës nga homologë e ekspertë ndërkombëtarë.

Në tre ditët e trajnimit u trajtua në mënyrë të detajuar roli i inspektimeve në gjykata dhe prokurori, respektimi i pavarësisë gjyqësore përmes gjetjes së balancës që inspektimet të mos ndërhyjnë në vendimmarrjen gjyqësore, garancitë etike dhe procedurale gjatë inspektimeve, përdorimi efektiv i instrumenteve të inspektimit dhe teknikave të përzgjedhjes, adresimi i sfidave praktike dhe përmirësimi i cilësisë dhe efikasitetit të përgjithshëm të inspektimeve. Pjesa teorike u kombinua me studime rastesh dhe dilema nga praktikat evropiane mbi inspektimet tematike dhe institucionale.

FOTO NGA AKTIVITETI





KL GjJ NUK PRANON KËRKESËN E ILD PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ GJYQTARES A.P.

Këshilli i Lartë Gjyqësor rrëzoi në istrative të Shkallës së Parë Tiranë”, për mbledhjen e sotme kërkesën e Inspektorit vendimet përfundimtare të dhëna nga këto të Lartë të Drejtësisë për procedim gjykata për periudhën 01.09.2022 – disiplinor me masën “Vërejtje publike” 30.12.2022. Pas analizës rast pas rasti, nga ndaj magistrates A.P., gjyqtare në ky inspektim rezultoi se në Gjykatën e Gjykatën e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për mosrespektim shëm Tiranë, 89 % e vendimeve janë do të afatit të arsyeshëm të dorëzimit të rëzuar brenda afatit 120 ditor. vendimit të arsyetuar.

ILD ka nisur hetimin me iniciativë ndaj gjyqtares, bazuar në konstatimet e raportit të inspektimit tematik të ILD-së, “Mbi procedurën e shpalljes dhe arsyetimit të vendimeve gjyqësore të Gjykatës së Shkallës së Parë Juridiksioni i Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile) dhe Gjykatës Admin-

Ky afat është vlerësuar si koha e arsyeshme, që i nevojitet gjyqtarit/gjykatës të dorëzojë vendimin përfundimtar të arsyetuar, pasi vetëm ky afat mund të bëjë dallimin dhe të shërbejë si një kohë e arsyeshme në situatën konkrete të ngarkesës, organikës dhe numrit të magistratëve, apo tipologjisë së çështjeve të gjykuara, mes

Hetimi disiplinor ndaj gjyqtares A.P. për mosrespektim të afatit të arsyeshëm të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, përfshinte 21 vendime të dorëzuara me vonesë. Për vonesën 2 vite e 4 muaj ILD ka kërkuar procedim, ndërsa për vonesat e tjera, ILD ka mbyllur hetimin dhe ka dërguar materialet në KLGJ për vlerësim profesional të magjistrates.

nevojës për të arsyetuar dhe dorëzuar të gjitha vendimet gjyqësore sipas afatit të parashikuar në nenin 308 të Kodit të Procedurës Civile dhe mundësisë e kapaciteteve aktuale të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë për të respektuar këtë afat.

Inspektimi pasoi me fillimin e verifikimeve për gjyqtarët e Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë, për vendimet e shpallura e të dorëzuara të arsyetuara në sekretari pas 120 ditëve nga shpallja.

Hetimi disiplinor ndaj gjyqtares A.P. për mosrespektim të afatit të arsyeshëm të dorëzimit të vendimit të arsyetuar, përfshinte 21 vendime të dorëzuara me vonesë. Për vonesën 2 vite e 4 muaj ILD ka kërkuar procedim, ndërsa për vonesat e tjera, ILD ka mbyllur hetimin dhe ka dërguar materialet në KLGJ për vlerësim profesional të magjistrates.

Hetimi konstatoi kryerjen e shkeljes disiplinore nga ana e magjistrates me pakujdesi në formë neglizhence; vonesat e evidentuara për një kohë të gjatë në arsyetimin e tre vendimeve gjyqësore; vonesat në arsyetimin

e vendimeve gjyqësore nuk justifikohen nga shkaqe të arsyeshme personale, shëndetësore, familjare, pavarësisht se ato janë të lidhura direkt me magjistraten. Si pasojë e mosveprimit të gjyqtares është cenuar prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cenuar besimi i publikut të drejtësia, kjo edhe në kushtet kur magjistratja ka një vjetërsi në detyrë prej mbi 19 vitesh si gjyqtare, tregues ky i njohjes shumë të mirë të saj mbi rolin e ushtrimit të detyrës me etikë dhe disiplinë të magjistratit.

Gjatë hetimit, ILD konsideroi si rrethana lehtësuese, mospasjen nga magjistratja të ndonjë mase disiplinore dhe sjelljen bashkëpunuese gjatë hetimit disiplinor, duke konkluduar se veprimet/mosveprimet e gjyqtares A.P., përbëjnë “Shkelje të lehtë” disiplinore e duke i propozuar Këshillit të Lartë Gjyqësor masën disiplinore “Vërejtje publike”, për gjyqtaren A.P., parashikuar nga neni 105, pika 1, shkronja “b”, ndarja “i” dhe neni 107 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Në seancën e sotme, Këshilli i Lartë Gjyqësor vendosi rrëzimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

QERSHORI I ILD NË SHIFRA

Gjatë muajit **Qershor 2025** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar 172 ankesa nga ta cilat 171 të depozituara nga qytetarë dhe 1 (një) nga institucione. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion gjatë muajit **Qershor 2025**.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët. Ato ndodhen në faza të ndryshme trajtimi, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.

ARKIVIME	VERIFIKIME	PROCESI DISIPLINOR
95 vendime nga 156 praktika të trajtuara: • 66 vendime arkivimi pas shqyrtimit fillestar; • 29 vendime arkivimi pas Verifikimit	• 25 vendime verifikimi	• 1 vendim për mbyllje hetimi disiplinor për 1 magjistrat (prokuror)

ANKIMI NË ILD

Për të lehtësuar procesin e ankimit për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posacëm ankese, i cili:

në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

- * mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- * të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- * mund të plotësohet pranë Zyrës së ILD,

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5 ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD www.ild.al, në seksionin “**Si pranohen ankesat**”.

SHPLLJE PUBLIKE E VENDIMEVE

Edhe gjatë muajit **Qershor** Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, ka bërë shpalljen publike të vendimeve të arkivimit, **për 5 ankues**, të cilët kanë rezultuar të paarrtshëm në adresat e komunikuar prej tyre. Përveçse në stendat e ILD-së, sipas ligjit këto shpallje gjenden edhe në faqen tonë zyrtare dhe të afishuara edhe në stendat e bashkive nga vijnë ankuesit.





Gjatë asistimit të ankuesve

Ekipi i zyrës së ankesave pret qytetarë-ankues çdo ditë pune nga ora 09.00-14.00, ndërsa për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas komunikimit përmes faqes dhe adresës zyrtare. Zyra e

Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.

Pjesë e ekipit është edhe Koordinatori për të drejtën e informimit.



Gjatë muajit Qershor 2025, Sektori i Ankesave dhe Marrëdhënieve me Publikun:

- ⇒ **ka pritur 34 ankues,** të cilët janë paraqitur në ambientet e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- ⇒ **ka realizuar 16 telefonata me qytetarë,** të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose Informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës.



KOORDINATORI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT

Në përputhje me parimet dhe rregullat e parashikuara në ligjin nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, koordinatori për të drejtën e informimit në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i mundëson çdo kërkuar të drejtën për t’u njohur me informacionin publik, si dhe komunikon sipas nevojës me kërkuar për trajtimin e kërkesës për informacion publik.

Kërkesa për informacion depozitohen nga qytetarët, personat juridikë, grupet e

interesuara, nëpërmjet Postës Shqiptare Sh.a., postës elektronike në adresën: **info@ild.al**, si dhe asaj të koordinatorit për të drejtën e informimit **amanta.jasa@ild.al**.

Informacionet e parashikuara në programin e transparencës publikohen dhe përditësohen në mënyrë të vazhdueshme në regjistrin e kërkesave dhe përgjigjeve, brenda afatit të parashikuar ligjor.

SHIFRA MUJORE

*Gjatë muajit **Qershor 2025**, pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, kanë mbërritur **20 kërkesa** për informacion, të cilat janë trajtuar në të gjitha rastet brenda 5 ditëve, (ligji parashikon që kërkuar t’i kthehet përgjigje brenda 10 ditëve).*

ILD NË TWITTER

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Jun 18

Nisi sot trajnimi i rradhës i njësisë së inspektorëve e ndihmës inspektorëve të #ILD mbi fazat specifike të inspektimeve. Eksperienca spanjolle dhe europiane me #EU4Justice #trajnimivazhdueshëm #ILD



4 61

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Jun 12

Në periudhën Shkurt 2020 – Prill 2025 #ILD ka zhvilluar 10 inspektime tematike pranë gjykatave dhe zyra të prokurorisë. Në total janë propozuar 108 rekomandime të cilat janë adresuar subjekteve të inspektimeve por edhe organeve të tjera. #KLGJ #KLP #ILD



From ild.al

1 15

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Jun 9

Secili nga ne e ka të qartë se çdo kategori shoqërore është e barabartë gjatë por secili në të përditshmen e vet mund ta ketë në vëmendje të vështirë një kategori si media dhe jo për të qenë miq me gazetarët por të qenë miq me lirinë e shprehjes



From ild.al

1 21

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Jun 12

Në periudhën Shkurt 2020 – Prill 2025 #ILD ka zhvilluar 10 inspektime tematike pranë gjykatave dhe zyra të prokurorisë. Në total janë propozuar 108 rekomandime të cilat janë adresuar subjekteve të inspektimeve por edhe organeve të tjera. #KLGJ #KLP #ILD



From ild.al

1 15

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · 2h


Përpunimi i ankesave #ILD

- ✓ 7656 të konfirmuara
- ✓ 6073 të trajtuara
- ✓ 1583 në proces trajtimi
- ✓ 144 në proces verifikimi pas shqyrtimit fillestar

Më shumë ild.al

Si procedohet me ankimin në ILD?

ild.al/sq/pyetje-te-s...



11

Inspektori i Lartë i Drejtësisë Artur Metani @ILD_Albania · Jun 9

Kohë e shpenzuar mirë për sigurinë e gazetarëve. Patjetër mund të mos bihet dakord për gjithçka, por e rëndësishme është të komunikohet, sepse zgjidhjet gjenden më shpejt në këtë mënyrë. #tryezë #siguriaemedia #KIE #BE



2 63

Qershor 2025

Të gjitha të drejtat e rezervuara

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al

Tel: +35542217217

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit",
Godina nr.13 Tiranë, Shqipëri



Spot prezantues ILD

Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë

[youtube.com](https://www.youtube.com)

*Kliko për të ndjekur spotin
prezantues të ILD*



Më skano!